




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË KORÇË

Nr. 30 Prot



Korçë më 11-3-2020

Lënda : Shpallje vendimi

Drejtuar : Bashkia Maliq

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë dy kopje të shpalljes së Vendimit Nr.45 dt 31.01.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë me qëllim vendosjen e shpalljes pranë këndit të afishimeve të vendbanimit të fundit për efekt të komunikimit për të paditurën Tereza Matraku.

Ju lutemi një kopje e shpalljes të kthehet në gjykatë e firmosur dhe e vulosur nga ana juaj duke konfirmuar datën e afishimit të saj.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

Nr: 48 prot  
Date: 30.04.2020

Kancelar

Aleksandër Dino



- Drg. Taj. Publik  
30.04.2020  
*[Handwritten signature]*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË KORÇË**  
**SEKRETARIA**

Nr. 30 Prot

Korçë më 11-3-2020

**Lënda :** Shpallje vendimi

**Pranë Këndit të afishimit të akteve :** Bashkia Maliq

**Për :** Tereza Matraku banuese në fshatin Vreshtas

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë përfundoi gjykimi i çështjes administrative me Nr.21/507 datë 17.06.2019 Regj.Themeltar me palë :

**Paditës :** Jani Cekani

**I Paditur :** Thanas Qelemeni, Josif Qelemeni, Angjelo Qelemeni, Tereza Matraku, Kristina Tërpollari, Komisoni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Korçë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Korçë

**Objekti:** Konstatim pavlefshmërie absolute të A.M.T.P nr.551/1 pa datë 11.08.2000 rubrika 2 për sipërfaqen e vendosur me palën paditëse e.t.j.

Në përfundim të gjykimit, me vendim Nr.45 datë 31.01.2020 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë vendosi :

- Rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar të këtij vendimi palëve ndërgjyqëse.

Kjo shpallje hartohet në tre kopje nga të cilat njëra afishohet në vendbanimin e të paditurës për 20 ditë, pranë Bashkia Maliq, njëra afishohet në këndin e afishimit të akteve në gjykatë dhe kopja tjetër qëndron në dosjen gjyqësore.

Vendosni konfirmimin tuaj se kjo shpallje u afishua në kopjen e saj.

Vërtetoj se shpallja u afishua në datë \_\_\_\_\_

Për Bashkia Maliq

\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, nënshkrim,)



**Kancelar**  
**Aleksandër Dino**